

VENDIM
Nr. 20, datë 11.11.2021

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pika “a”, “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 20, datë 11.11.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Drejtoria I, dosje nr. 99, “Procesverbal mbi dorëzimin e dosjeve hetimore e gjyqësore të grupit armiqësor të sabotatorëve, A.K. me bashkëpunëtorët e tij”, 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret i rëndësishë së veçantë”. Dosja daton në vitet 1977.

2. Dosje formulare nr. 1962, në ngarkim të A.K., me 109 (njëqind e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1975–1977. Dosja i përket fondit ish-Dega IV.

3. Fondi 4, dosje nr. 191 “Dorëshkrime të A.K., me 227 (dyqind e njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1975–1977.

4. Fondi 4, dosje nr. 192 “Dorëshkrime të A.K.”, me 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1975–1977.

5. Dosje me 4 fashikuj, në total me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1984. Dosja i përket fondit ish-Dega IV.

6. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 473, “Mbi disa mbishpenzime gjatë punës për montimin e fabrikës së pllakave në Elbasan”, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja daton në vitet 1990.

7. Dosje përpunimi nr. 1714, në ngarkim të Gj.M., me 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1974–1983. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.

8. Dosje agjenturore “Sorra” nr. 1196, në ngarkim të S.B., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja daton në vitet 1987–1988. Dosja i përket fondit ish-Dega IV.

9. Dosje përpunimi nr. 3201, në ngarkim të S.B., me 209 (dyqind e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1974–1990. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Berat.

10. Dosje formulare nr. 2 dhe nr. 2/1, në ngarkim të S.S., me 2 volume, në total me 624 (gjashtëqind e njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1946–1990. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.

11. Fashikull nr. 574, në ngarkim të R.P., me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1959–1990. Dosja i përket fondit ish-Të Arratisur.

12. Dosje kërkimi dhe dosje fomulare nr. 574, në ngarkim të Gj.N., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1951–1968. Dosja i përket fondit ish-të Arratisur.

13. Dosje agjenturore nr. 161 “Rrufeja”, me 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja daton në vitet 1951–1973. Dosja i përket fondit ish-Operativ.

KRYETAR E KOMISIONIT
TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula